



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERICKOG NARODA




RAPORTI MBI SHPENZIMET E KOMUNËS **GRAÇANICA**

PARATË DHE POLITIKA

● ● AVANCOJMË KOSOVËN SË BASHKU

LOCAL
SOLUTION




RAPORTI MBI SHPENZIMET E KOMUNËS

GRAÇANICA

PARATË DHE POLITIKA

● ● AVANCOJMË KOSOVËN SË BASHKU





Implementing Persons and Organizations for this report:

STEFAN STOJANOVIĆ – Communication for Social Development

OLIVER VUJOVIĆ – Communication for Social Development

Financuar nga:



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA





Përshkrimi i projektit:

Ky projekt i mbështetur nga Advancing Kosovo Together – Local Solutions (AKT-LS) përmes USAID, ka për qëllim të rrisë integritetin e qeverive lokale duke shtuar monitorimin nga shoqëria civile në këto komuna. Pjesëmarrësit në këtë projekt janë aftësuar: të kenë casje në informatat për tenderët publikë në nivel komunash, të identifikojnë lidhjet politike në mes të kompanive apo personave që kanë fituar tenderë por që më herët kanë qenë donator të partive politike, gjithashtu edhe verifikimin e deklaramit të pasurisë së zyrtarëve të lartë shtetëror. Pjesëmarrësit kishin për detyrë që këto njohuri t'i aplikojnë në komunat e tyre dhe të shkruajnë një raport mbi të gjaturat. Kjo punë reflekton njohuritë dhe metodologjinë e fituar nga trajnimi.

Deklaratë mohimi

Pikëpamjet e shprehura në këtë raport janë punë e pjesëmarrësve në këtë projekt. Hulumtimi në këto raporte është vetëm punë e këtyre personave dhe jo e organizatave përfaqësuese. Ato gjithashtu nuk reflektojnë qëndrimet e donatorëve të këtij projekti, United States Agency for International Development (USAID). Këto pikëpamje gjithashtu nuk paraqesin qëndrimet e organizatave implemetuese Communication for Social Development dhe Organizatës Çohu!.

Publikuar nga

Organizata për Demokraci, Antikorrupsion dhe Dinjitet, Çohu!
Rruga: Rustem statovci Nr.17; Prishtinë, Kosova
Tel / +381 (0)38 248 506
www.cohu.org

PËRMBAJ

09

Hyrja

10

Mallrat dhe
Shërbimet

14

Kontratat e
nënshkruara
nga komuna e
Graçanicës përmes
procedurave të
prokurimit publik

09

Të gjeturat
kyçe

TJA

20

Të gjeturat e
Auditorit Gjeneral
për Komunen e
Graçanicës

22

Financimi i
subjekteve
politike

17

Kompanitë
që fituan më
së shumti
tenderë nga
KK Graçanicë

21

Ankesat në OSHP

22

Lidhjet e
biznesit me
politikën

23

Përfundime dhe
Rekomandime



RAPORTI MBI SHPENZIMET E KOMUNËS

GRAÇANICA

HYRJA

Komuna e Graçanicës gjatë viteve 2009-2012 ballafaqohet me veshtiresi të vogla funksionale sa i përket planifikimit të buxhetit për investime kapitale dhe prokurimit publik, si dhe vështirësi sa i përket shpenzimeve buxhetore. Kjo mund të shihet si gjë normale duke pasur parasysh se Komuna e Graçanicës u formua pas procesit të decentralizimit. Në pjesën e dytë, gjegjësisht në periudhën 2013-2015 mund të shihet se funksionaliteti operacional dhe profesionalizmi janë rritur. Fondet janë shpenzuar në mënyrë më efikase dhe rezultatet janë të prekshme.

Komuna e Graçanicës ka listën e zezë të ndërmarrjeve të cilat nuk mund të aplikojnë për tenderë. Në këtë listë figuron vetëm një ndërmarrje, ajo është “Conex Group” nga Prishtina. Kjo është bazuar në kërkesën tonë për informata për listen e zezë; megjithatë ne kemi marrë vetëm emrin e kompanisë, pa arsyetimin përse kjo kompani sipas tyre është në atë listë. Kur flasim për ndërmarrjet mund të themi se, bazuar në hulumtimin tonë, ekzistojnë 39 projekte nga 236 projekte sa janë gjithsej, të realizuara nga kompanitë që vijnë nga Komuna e Graçanicës. Këto 39 projekte kapin vlerën prej 1,461,559 euro, që është rreth 7,3% të vlerës totale të tenderëve të realizuar.

Në vijim mund të shihni se si Komuna e Graçanicës i ka planifikuar dhe i ka realizuar burimet nga fondet për investime kapitale dhe prokurimi publik.

TË GJETURAT KYÇE

1 / Prokurimi publik

1.1 / Investimet e planifikuar kapitale në Komunë

Komuna e Graçanicës për investime kapitale dhe prokurim publik në periudhën 2009-2015 ka alokuar fonde të planifikuara si në vijim:

Për vitin 2015, të dhënat do të jenë të gatshme në gjysmën e vitit 2016 nga Zyra e Auditorit Gjeneral



INVESTIMET KAPITALE

TË PLANIFIKUARA
€ 3,557,524

TË SHPENZUARA
3,506,329

2010

TË PLANIFIKUARA
€ 2,267,628

TË SHPENZUARA
€ 2,190,708

2011

TË PLANIFIKUARA
€ 3,552,740

TË SHPENZUARA
€ 3,225,701

2012

TË PLANIFIKUARA
€ 2,857,270

TË SHPENZUARA
€ 2,001,550

2013


TË PLANIFIKUARA
€ 2,428,343

TË SHPENZUARA
€ 1,667,159

2014



MALLRAT DHE SHËRBIMET



Komuna e Graçanicës për vitin 2010 për investime kapitale, mallra dhe shërbime ka planifikuar 4,225,395 €. Nga kjo shumë janë shpenzuar gjithsej 4,135,903 €, ndërsa diferenca ndërmjet vlerës së planifikuar dhe asaj të shpenzuar është 89,429 €. Kjo diferencë ka ardhur si rezultat i planifikimit të dobët të burimeve në

dispozicion, thuhet në raportin e Auditorit për këtë vit. Gjithashtu, raporti i Auditorit thekson se edhe planifikimi i investimeve kapitale dhe prokurimit publik nuk ishte definuar qartë, derisa shpenzimet e buxhetit kanë qenë të duhura sepse vetëm 2,5% të burimeve totale kanë mbetur të pashfrytëzuara.

INVESTIMET KAPITALE

Në fillim të vitit, për investime kapitale ishin planifikuar 370,729 €, e kjo ndryshoi gjatë vitit. Me donacionet për Komunën e Graçanicës, buxheti për investime kapitale u rrit në vlerën 3,557,524 €. Nga vlera e lartpërmendur, shpenzimet për vitin 2010 ishin 3,506,329 €. Për investime kapitale nuk janë shfrytëzuar 51,195 €.

MALLRAT DHE SHËRBIME

Në fillim të vitit, për shpenzime në Mallra dhe shërbime ishin planifikuar 717,896 €, dhe kjo poashtu ndryshoi gjatë vitit. Buxheti për Mallra dhe shërbime u zvogëlua në 667,871 €. Në vitin 2010, për mallra dhe shërbime u shpenzuan 629,574 €, që është për 38,297 € më pak sesa ishin planifikuar. Kjo diferencë mbeti e pashfrytëzuar.

AUDITIMI

Pas inspektimit të dokumentacionit për prokurimin e mallrave, shërbimeve dhe të kapitalit, Auditori konstatoi gjetjet si në vijim:

- Komuna nuk ka plan përfundimtar të prokurimit për vitin 2010;
- Komuna nuk ka listë përfundimtare të: prokurimit të mallrave në vitin 2010;
- Dokumentacioni i rasteve të prokurimit nuk është i kompletuar;

- Komuna e Graçanicës për vitin 2011 për prokurim publik ka planifikuar
- të shpenzojë 3,035,257 €. Nga shuma e planifikuar janë shpenzuar
- 2,941,920 €, ndërsa dallimi ndërmjet shumës së planifikuar dhe asaj të
- shpenzuar është 93,337 €, dhe këto mjete nuk janë shfrytëzuar.

AUDITORI REKOMANDON QË KOMUNA TË SIGUROJË:

- Krijimin e një plani vjetor të prokurimit, dhe atë t'ia dërgojë APP-së (Agjencionit për Prokurim Publik);
- Finalizimin dhe mirëmbajtjen e skedarëve/dosjeve për çdo prokurim të kryer;
- Kompletimin e dokumentacionit gjatë pranimit të Mallrave dhe shërbimeve;

Gjithashtu ekzistojnë tetë raste të gabimeve për shkak të mungesës së dokumentacionit të duhur gjatë pranimit të mallrave; Konkretisht, në të tetë rastet, mungojnë shënimet e komisionit, dhe procesverbalet nuk janë nënshkruar. Të gjitha këto gabime dhe lëshime kanë ndikuar në shfrytëzimin e duhur të fondeve publike.

Komuna e Graçanicës për vitin 2011 për prokurim publik ka planifikuar të shpenzojë 3,035,257 €. Nga shuma e planifikuar janë shpenzuar 2,941,920 €, ndërsa dallimi ndërmjet shumës së planifikuar dhe asaj të shpenzuar është 93,337 €, dhe këto mjete nuk janë shfrytëzuar. Mund të shohim se buxheti i planifikuar dhe i shpenzuar për vitin 2011 është më i vogël se ai i vitit 2010. Komuna e Graçanicës ka pasur 1,190,138 € më pak buxhet të planifikuar dhe 1,193,983 € më pak buxhet të shpenzuar.

INVESTIMET KAPITALE

Në fillim të vitit, për investime kapitale ishin planifikuar 1,486,688 €, e kjo ndryshoi gjatë vitit. Me donacionet për Komunën e Graçanicës, buxheti për investime kapitale u rrit në vlerën 2,267,628 €. Nga vlera e lartpërmendur, shpenzimet për vitin 2010 ishin 2,190,708 €. Për investime kapitale nuk janë shfrytëzuar 76,920 €.

MALLRAT DHE SHËRBIMET

Në fillim të vitit, për shpenzime në mallra dhe shërbime ishin planifikuar 545,289 €, gjendje e cila ndryshoi gjatë vitit. Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2011 u rrit nga buxheti i planifikuar për 767,629 €, që i mundësoi komunës të planifikojë prokurim për vlerën e përmendur. Për mallra dhe shërbime komuna shpenzoi gjithsej 751,212 €, që është 16,417 € më pak sesa buxheti i planifikuar.

AUDITIMI

Buxheti i planifikuar final për vitin 2011 ishte 5,671,059 €. Shpenzimet për këtë vit ishin 4,757,254 €, apo 84% të buxhetit të realizuar. Këtu shihet qartë se 16% i buxhetit mbetet i pashfrytëzuar për shkak të planifikimit të dobët, thotë Auditori për këtë vit.

MANDIMET PËR KOMUNËN E GRAÇANICËS PËR VITIN 2011.

- Plani i buxhetit vjetor të përgatitet sipas vlerësimeve të qëndrueshme, duke analizuar shpenzimet dhe realizimet e projekteve sa më herët që është e mundur. Pra, të fillohet me procedurat e furnizimit sa më parë.
- Të bëhet analiza mujore e shpenzimeve buxhetore në ato fusha ku është e mundur, dhe në përputhje me këtë të hartohen planet për alokimet tremujore të buxhetit.

Në bazë të Zyrës së Auditorit Gjeneral për vitin 2011, Komuna e Graçanicës ballafaqohet me problemet e njëjta sikurse një vit më parë sa i përket dokumentacionit. Te "Furnizimi me pajisje laboratorike për spitalin e Graçanicës" dhe "furnizimi me pajisje laboratorike për shtëpitë e shëndetit" ekziston problemi me listat e specifikuar të pajisjeve të blera, prandaj ekziston dyshimi se pajisjet nuk janë adekuate. Në rastin "Ndërtimi i çesmes për ujë të pijes në Donja Gusterica" me gjithë vonesat e vazhdueshme në kryerjen e punëve, Komuna nuk ka shqiptuar ndonjë dënim.

Komuna e Graçanicës për vitin 2012 për prokurim publik ka planifikuar të shpenzojë 4,442,734 €. Nga shuma e planifikuar, janë shpenzuar 4,113,377 €, dhe dallimi ndërmjet shumës së planifikuar dhe asaj të shpenzuar është 329,357 €. Nëse shikohet buxheti për këtë vit, diferenca është vetëm 7.4 %, që do të thotë se realizimi i buxhetit ka qenë 93% që është relativisht mirë, sipas të gjeturave të raportit të Auditorit për këtë vit.

- Buxheti i planifikuar final për vitin 2011 ishte 5,671,059 €. Shpenzimet
- për këtë vit ishin 4,757,254 €, apo 84% të buxhetit të realizuar. Këtu shihet
- qartë se 16% i buxhetit mbetet i pashfrytëzuar për shkak të planifikimit të
- dobët, thotë Auditori për këtë vit.

INVESTIMET KAPITALE

Plani i shpenzimeve për investime kapitale për këtë vit ka qenë 1,905,858 €, dhe kjo shumë ka ndryshuar gjatë vitit. Buxheti i planifikuar final për vitin 2012 ka qenë 3,552,740 €. Nga vlera totale e këtij buxheti, në vitin 2012 janë shpenzuar 3,225,701€, derisa 327,039 € kanë mbetur të pashfrytëzuara. Këto burime të pashfrytëzuara u bartën për investime kapitale për vitin vijues.

MALLRAT DHE SHËRBIMET

Në fillim të vitit, për shpenzime në Mallra dhe shërbime ishin planifikuar 603,671 €, dhe kjo poashtu ndryshoi gjatë vitit. Buxheti final për Mallra dhe shërbime për vitin 2012 është rritur për 889,994 € nga buxheti i planifikuar. Nga vlera totale e mjeteve në dispozicion, Komuna ka shpenzuar 887,676 €, dhe vetëm 2,318 € kanë mbetur të pashfrytëzuara.

AUDITIMI

Sipas raportit të Auditorit, në vitin 2012 Komuna ka shpenzuar 90% të buxhetit, që paraqet një performansë relativisht të mirë.

Në bazë të të gjeturave të ZAP-it për vitin 2012, në katër raste Komuna ka nënshkruar kontrata me palët, të cilat më pas nuk i ka kontrolluar për ndonjë mosrespektim të kontratës. Situatat e lartpërmendura e rrezikojnë implementimin e tenderëve të lartpërmendur. Komuna e Graçanicës për vitin 2013 për prokurim publik ka planifikuar të shpenzojë 3,828,270 €. Nga shuma e planifikuar, janë shpenzuar 2,654,805 €, dhe dallimi ndërmjet shumës së planifikuar dhe asaj të shpenzuar është 1,173,919 €. Kjo diferencë është pasojë e planifikimit joadekuat të mjeteve në dispozicion, thuhet në raportin e Auditorit.

INVESTIMET KAPITALE

në fillim të vitit, plani për shpenzimet në investimet kapitale ishte 2,350,630 €. Buxheti final për investimet kapitale për vitin 2013 ka qenë 2,857,270 €. Nga vlera e lartpërmendur, shpenzimet për vitin 2013 ishin 1,919,853 €. Buxheti final për investimet kapitale u rrit për 506,640 €. Edhe pse ka pasur rritje të buxhetit për investimet kapitale, shpenzimi i mjeteve në dispozicion arriti vlerën prej vetëm 67 %.

MALLRAT DHE SHËRBIMET

Në fillim të vitit, buxheti për Mallra dhe shërbime ishte 938,650 €, dhe gjatë vitit kjo vlerë u rrit në 971,454 €. Për Mallra dhe shërbime u planifikuan 734,952 €, ndërsa 236,502 € mbetën të pashfrytëzuara.

AUDITIMI

Te kategoria e mallrave dhe shërbime, buxheti i shpenzuar ishte 76%. Krahasuar me vitin e kaluar, mjetet për këtë vit janë më të mëdha, derisa shpenzimet ishin më të vogla për 152,724 €. Këto parametra tregojnë se buxheti nuk zhvillohet sipas analizave dhe nuk është i bazuar në nevojë. Këto janë komente të Zyrës së Auditorit Gjeneral që tregojnë se, krahasuar me rezultatet paraprake, Komuna e Graçanicës ka mundur të ketë performansë shumë më të mirë.

Në bazë të të gjeturave të ZAP-it, Komuna e Graçanicës për vitin 2013 ka pasur probleme si në vijim: Në rastin "Furnizimi me lule dhe materiale tjera për mirëmbajtje" me vlerë 12,245€, komuna i ka zotuar këto mjete me vonesë. Në rastin tjetër, gjegjësisht të "Furnizimi me material ndërtimor i familjeve me probleme të strehimit për ndërtim të shtëpive" Komuna e Graçanicës e ka përzgjedhur një operator ekonomik pa u konsultuar me departamentin e prokurimit. Këto probleme mund të paraqesin rrezik në implementimin e tenderëve, thotë Zyra e Auditorit Gjeneral.

Sipas të dhënave që i kemi marrë nga Komuna, shpenzimet për vitin 2013 kanë qenë 2,001,550 €, e kjo vlerë dallon nga vlera në raportin e Auditorit.

Në raportin e realizuar nga CSD janë shfrytëzuar shifrat e raportit të Auditorit.

Komuna e Graçanicës për vitin 2014 për prokurim publik ka planifikuar të shpenzojë 3,471,092 €. Nga shuma e planifikuar, janë shpenzuar 2,503,403 €, dhe dallimi ndërmjet shumës së planifikuar dhe asaj të shpenzuar është 967,689 €. Kjo diferencë është pasojë e planifikimit joadekuat të mjeteve në dispozicion, thuhet në raportin e Auditorit.

INVESTIMET KAPITALE

Në fillim të vitit, plani për shpenzimet në investimet kapitale ishte 2,054,539 €. Buxheti final për investimet

kapitale për vitin 2014 ka qenë 2,428,343 €. Nga vlera e lartpërmendur, shpenzimet për vitin 2014 ishin 1,677,159 €. Përkundër rritjes së buxhetit për 373,804 € me të hyra vetanake dhe burime nga viti i kaluar, në këtë kategori u shpenzuan vetëm 69% të mjeteve. 31% i pashfrytëzuar është rezultat i planifikimit të dobët dhe dështim i efikasitetit të menaxhmentit, thuhet në raportin e Auditorit.

MALLRAT DHE SHËRBIMET

Në fillim të vitit, buxheti për Mallra dhe shërbime ishte 880,150 €. Gjatë vitit, ky buxhet u rrit në vlerën 1,042,749 €. Te kategoria e Mallrave dhe shërbimeve, buxheti i shpenzuar ishte 836,271 €.

Sipas raportit të Auditorit për këtë vit, Komuna e Graçanicës ka pasur probleme të ngjashme gjatë gjithë vitit sa i përket zbatimit të kontrolleve efikase të projekteve. Në 5 raste me vlerë prej € 368.935 nuk kishte plan adekuat të menaxhimit të kontratave. Një mangësi tjetër shfaqet te procesverbalet të cilat nuk përmbajnë informacione të sakta sa i përket tenderëve. Në raportin e Auditorit, ka minuta të takimeve që përmbajnë të dhëna të pasakta Si pasojë, ka pasur 8 pagesa për larjen dhe pastrimin e rrugëve në vlerë prej € 91.635 €, si dhe 8 pagesa në vlerë prej 35.516 € për mirëmbajtje të rrugëve, që janë bërë nga buxheti i investimeve kapitale. Ndryshe nga vitet e kaluara, mund të vijmë në përfundim se Komuna e Graçanicës nuk ka pasur shumë parregullsi dhe vështirësi në implementimin e projekteve, derisa projektet e lartpërmendura paraqesin probleme sa i përket implementimit të procedurave gjegjëse të prokurimit.


KONTRATAT E NËNSHKRUARA NGA KOMUNA E GRAÇANICËS PËRMES PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PUBLIK

Transparenca dhe bashkëpunimi i Komunës së Graçanicës akoma nuk është në nivelin e kënaqshëm. Kjo për arsye se kërkesa për qasje në dokumente publike që i është dërguar Komunës së Graçanicës për numrin e kontratave të planifikuara dhe realizuara përmes procedurave të prokurimit publik në periudhën 2010-2015 nuk ka hasur në përgjigje.

Kopja fizike e kërkesës i është dorëzuar komunës më 13 prill 2016.

Më 22 prill 2016, ekipi hulumtues ka pranuar përgjigje elektronike se administratës do t'i duhet më shumë kohë për përgatitjen e dokumentacionit të kërkuar, dhe se dokumentacioni i kërkuar do t'i dërgohet CSD-së. Për fat të keq, kjo nuk ndodhi dhe më 27 prill 2016 ekipi hulumtues ka marrë përgjigje se informacionin e kërkuar po e presin nga një institucion tjetër, dhe sapo ta marrin, do ta përcjellin te CSD-ja, pa e cekur emrin e institucionit.

Nga të dhënat që ne kemi nxerrur nga web faqja e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik (KRPP), del të jetë që KK Graçanicë ka nënshkruar 236 kontrata me vlerë të madhe dhe të mesme përmes prokurimit publik



Duke u nisur nga hulumtimi ynë dhe rezultatet e prezantuara në tabelën paraprake, tenderët e mëdhenj dhe të mesëm janë si në vijim:

- Në vitin 2010 Komuna e Graçanicës ka realizuar 40 tenderë, nga të cilët 31 kontrata janë të llojit “punë” dhe nëntë kontrata janë të llojit “furnizim”
- Në vitin 2011 Komuna e Graçanicës ka realizuar 49 tenderë, nga të cilët 32 kontrata janë të llojit “punë”, dhjetë kontrata janë të llojit “furnizim” dhe shtatë kontrata janë të llojit “shërbime”
- Në vitin 2012 Komuna e Graçanicës ka realizuar 36 tenderë, nga të cilët 28 kontrata janë të llojit “punë”, katër kontrata janë të llojit “furnizim” dhe 4 kontrata janë të llojit “shërbime”
- Në vitin 2013, Komuna e Graçanicës realizoi 45 tenderë nga të cilët 37 kontrata janë të llojit “punë”, pesë janë të llojit “furnizim” ndërsa tri janë të llojit e “shërbime”


- Në vitin 2014 Komuna e Graçanicës ka realizuar 38 tenderë, nga të cilët 30 kontrata janë të llojit “punë”, dhe tetë janë të llojit “furnizim” Në vitin 2015 Komuna e Graçanicës ka realizuar 28 tenderë, nga të cilët 13kontrata janë të llojit “punë”, 13janë të llojit “furnizim”, dhe dy janë të llojit “shërbime”

Nga informatat e lartcekura, mund të shihet se për periudhën 2010-2015, Komuna ka realizuar 236 procedura të tenderimit. 171 tenderë janë të llojit “punë”, 49 janë të llojit “furnizim” dhe 16 tenderë janë të llojit “shërbime”

Në bazë të 236 tenderëve të analizuar ku prej tyre 81 tenderë ishin në konzorcium me dy a më shumë ndër-marrje, vlerësohet se për periudhën 2010 janë shpenzuar 19,377,880 € që paraqiten në tabelën në vijim:

Viti	Numri i tenderëve	Vlera
2010	40	€ 4,447,371.93
2011	49	€ 3,064,379.00
2012	36	€ 6,653,228.00
2013	45	€ 2,495,577.00
2014	38	€ 1,465,160.00
2015	28	€ 1,252,164.00
Total	236	€ 19,377,879.93

Shuma e shpenzuar përmes prokurimit publik



Në bazë të hulumtimeve:

- Në vitin 2010 Komuna e Graçanicës ka realizuar 31 tenderë të llojit “punë” të llojit për të cilët ka shpenzuar 3,911,116.93 €, nëntë tenderë të llojit “furnizim” për të cilët ka shpenzuar 546,225 €,
- Në vitin 2011 Komuna e Graçanicës ka realizuar 32 tenderë të llojit “punë” për të cilët ka shpenzuar 2,218,819.00 €, dhjetë tenderë të llojit “furnizim” për të cilët ka shpenzuar 355,008 €, dhe shtatë tenderë të llojit “shërbime” për të cilët ka shpenzuar 490,552 €.
- Në vitin 2012 Komuna e Graçanicës ka realizuar 28 tenderë të llojit “punë” për të cilët ka shpenzuar 6,485,900.00 €, katër tenderë të llojit “furnizim” për të cilët ka shpenzuar 131,370 €, dhe katër tenderë të llojit “shërbime” për të cilët ka shpenzuar 35,958 €.
- Në vitin 2013 Komuna e Graçanicës ka realizuar 37 tenderë të llojit “punë” për të cilët ka shpenzuar 2,144,783 €, pesë tenderë të llojit “furnizim” për të cilët ka shpenzuar 233,658 €, dhe tre tenderë të llojit “shërbime” për të cilët ka shpenzuar 117,136 €.
- Në vitin 2014 Komuna e Graçanicës ka realizuar 31 tenderë të llojit “punë” për të cilët ka shpenzuar 1,257,606 €, tetë tenderë të llojit “furnizim” për të cilët ka shpenzuar 207,554 €, Në vitin 2015 Komuna e Graçanicës ka realizuar 13 tenderë të llojit “punë” për të cilët ka shpenzuar 751,942 €, 13 tenderë të llojit “furnizim” për të cilët ka shpenzuar 469,178 €, dhe dy tenderë të llojit “shërbime” për të cilët ka shpenzuar 31,044 €.

KOMPANITË QË FITUAT MË SË SHUMTI TENDERË NGA KK GRAÇANICË


Në bazë të të dhënave që ne kemi nxjerrur, pesë kompani kanë fituar 107 tenderë apo 45.33% të tenderëve në komunën e Graçanicës.

- 1 Ndërmarrja “**Vizion Project**” nga Prishtina është ndërmarrje që ka fituar numrin më të madh të tenderëve. Kjo ndërmarrje ka përfituar 25 tenderë, ku vetëm një tender i përket llojit “shërbime” në vlerë prej 18,013 €, derisa 24 tenderët tjerë janë të llojit “punë” në vlerë totale prej 1,251,443 €.
- 2 Ndërmarrja e dytë me numrin më të madh të tenderëve të fituar është “**Conex Group**” nga Prishtina. Kjo ndërmarrje ka përfituar 18 tenderë, dhe të gjithë tenderët i përkasin llojit “punë” në vlerë totale prej 2,267,394 €.
- 3 Ndërmarrja tjetër me numrin më të madh të tenderëve është “**Europa Partners**” nga Prishtina. Kjo ndërmarrje ka përfituar 18 tenderë në vlerë totale prej 886,040 € të gjitha të llojit “punë”.
- 4 Ndërmarrja e katërt është “**Sinani**” nga Prishtina me 16 tenderë. Të gjithë tenderët janë të llojit “punë” në vlerë totale prej 916,748 €.
- 5 Vendin e pestë e zënë dy ndërmarrje me numër të barabartë tenderësh. Secila nga ndërmarrjet përfitoi nga 15 tenderë. Këto janë “**Delta ing**” nga Prishtina, dhe “**ABC**” nga Podujeva. Të gjithë tenderët janë të llojit “punë”. Vlera totale e tenderëve të ndërmarrjes “ABC” ishte 1,911,622 €, derisa “Delta ing” përfitoi 455,361 €.

Nga vlera totale e kontratave (19,377,880 €), pesë kompani kanë marrë 13,597,861 €, apo 70% të vlerës totale të kontratave


Edhe pse ndërmarrja “Vizion Project” ka realizuar numrin më të madh të tenderëve, vlerën më të madhe e ka realizuar “Rexha Company”. Në periudhën 2010-2015, “Rexha Company” ka përfituar 4,072,352 € nga tenderët publik . Ndërmarrjet tjera nga top pesëshja janë “Project Plus” me vlerë 3,898,916 €, “Conex Group” me vlerë 2,267,394 €, “ABC Company” me vlerë 1,911,622 € dhe “Tekno ing Consulting” me vlerë 1,447,577 €.

Kompanitë që fituan më së shumti tenderë



- Në periudhën 2010-2015, “Rexha Company” ka përfituar 4,072,352 € nga tenderët publik . Ndërmarrjet tjera nga top pesëshja janë “Project Plus” me vlerë 3,898,916 €, “Conex Group” me vlerë 2,267,394 €, “ABC Company” me vlerë 1,911,622 € dhe “Tekno ing Consulting” me vlerë 1,447,577 €.

Kompanitë që kanë fituar më së shumti tenderë sipas vlerës



TË GJETURAT E AUDITORIT GJENERAL PËR KOMUNEN E GRAÇANICËS

2010

Pas analizimit të dokumentacionit në Komunën e Graçanicës për vitin 2010, sa i përket prokurimit publik ZAP thekson çështjet në vijim:

- Komuna e Graçanicës nuk ka pasur plan final të prokurimit për vitin 2010;
- Nuk ka pasur listë përfundimtare të prokurimeve të realizuara në vitin 2010;
- Dokumentacioni i prokurimit ishte jokomplet;

Në procesin e rishikimit të disa prokurimeve të Mallrave dhe shërbimeve Auditori gjeti disa mangësi në procedura të prokurimit, siç janë:

- Mungesa e dokumentacionit adekuat gjatë pranimi të Mallrave;
- Nuk ka pasur shënime të dërgesës të bashkëngjitura në fatura;

Mungesat e lartpërmendura janë rezultat i kontrolleve të pamjaftueshme në fushën e prokurimit. Kontrollat e dobëta vërehen sidomos në planifikimin vjetor të prokurimit dhe regjistrimin e aktiviteteve të prokurimit. Në mungesë të një plani vjetor të prokurimit, Komuna ka ndërmarrë veprime ad-hoc për të realizuar procedurat. Rezultati i kësaj është joefikasiteti i caktuar në përdorimin e fondeve publike.

2011

Disa nga proceset nuk janë të përcaktuara siç duhet, si: procesi i mbikëqyrjes, ndarja e detyrave dhe verifikimi. Mungesa e rregullave dhe politikave të brendshme dhe gabimet në zbatimin e procedurave kanë shkaktuar këto dështime edhe në procedurat e kontrollit.

Rekomandimi i Auditorit nga viti i kaluar në lidhje me dokumentacionin e krijuar gjatë pranimi të Mallrave nuk është adresuar. Si rezultat i mosadresimit të këtij rekomandimi, në vitin 2011 ka pasur parregullsi specifike në realizimin e prokurimit publik.

Në procesin e rishikimit dhe të monitorimit, Auditori i përgjithshëm ka theksuar çështjet në vijim:

- Mungesa e dokumentacionit;
- Vonesat në realizimin e punimeve janë vërejtjet kryesore të Auditorit për Komunën e Graçanicës.

Auditori Gjeneral ka gjetur dobësitë e mëdha të kontrollit në terren që si pasojë ka prodhuar vonesa në realizimin e punëve. Për të pasur më shumë sukses në këtë sektor, Kryetarit të Komunës i rekomandohet që:

- Planet vjetore të prokurimit të hartohen dhe të dorëzohen me kohë;
- Të ndërmerren masat për kontroll të brendshëm të prokurimit, dhe që të gjitha aktivitetet e prokurimit të zhvillohen në përputhje me LPP-në;
- Të forcohet menaxhmenti dhe kontrolli i projekteve në mënyrë që punët dhe shërbimet të realizohen në kuadër të afatit të kontraktuar.

2012

Rekomandimi për planet vjetore të prokurimit dhe për dorëzimin e tyre u adresua këtë vit, dhe Komuna e Graçanicës i ka hartuar dhe dorëzuar planet me kohë. Në përputhje me këtë, sektori i prokurimit publik duket se ka bërë punë më të mirë në vitin 2012. Një koment i Auditorit Gjeneral ishte se në 4 raste Komuna e Graçanicës kishte nënshkruar kontrata pa siguruar mjete të nevojshme.

Në lidhje me këtë Kryetarit të Komunës i është rekomanduar të sigurojë mjete të mjaftueshme para realizimit të prokurimit.

2013

Në prokurimin publik për 2013 Auditori Gjeneral në Komunën e Graçanicës ka testuar 8 mostra. Janë gjetur vonesa në kryerjen e pagesave të disa tenderëve, si dhe mungesa të dokumentacionit në tenderët tjerë.

Mosrespektimi i procedurave të rregullta dhe vonesat në kryerjen e pagesave shtojnë rrezikun e shpenzimit joefikas të parave të buxhetit të prokurimit publik. E gjithë kjo tregon se komuna e Graçanicës ende përballet me vështirësi.

Kryetarit të Komunës i rekomandohet të kryejë analiza të brendshme dhe të shikojë pse disa kërkesa specifike të prokurimit nuk adresohen te të gjitha rastet e prokurimit, dhe të zbatojë kontrolle të gjera për të siguruar që mangësitë të identifikohen dhe të adresohen në mënyrë efikase.

2014

Pas analizimit të dokumentacionit në Komunën e Graçanicës për vitin 2014, sa i përket prokurimit publik Auditori Gjeneral vuri në pah vështirësitë me të cilat ballafaqohet Komuna. Auditori ka analizuar 9 kontrata dhe 27 pagesa dhe ka identifikuar mangësi të zakonshme që kanë të bëjnë me moszbatimin e kërkesave, dhe mungesën e vendosjes së një kontrolli efikas, që ishte edhe rekomandimi i vitit të kaluar.

Komuna e Graçanicës nuk ka pasur plan të menaxhimit të kontratave për pesë (5) kontrata në fushën e punëve.

ANKESAT NË OSHP)

Në periudhën 2010-2015 në adresë të KRPP-së kanë arritur 13 ankesa që tregojnë për mosrespektimin e procedurave të tenderimit si dhe për parregullsitë e bëra në Komunën e Graçanicës.

Raporti për të gjitha ankesat e kompanive në Organin Shqyrtues të Prokurimit lidhur me dyshimet për parregullsi në realizimin e tenderëve në Komunën e Graçanicës për periudhën 2010-2015 tregon se nga 13 ankesat e paraqitura te Organi Shqyrtues i Prokurimit, 2 janë tërhequr në një periudhë të caktuar kohore, dhe vetëm 11 janë miratuar pjesërisht. Ankesat e miratuara pjesërisht janë ato ankesa që nuk janë miratuar nga gjykatat për shkak të mungesës së dëshmive adekuate. Në të shumtën e rasteve ankesat kishin të bënin me transparencë jo të duhur të tenderëve, si dhe me mosrespektimin e kriterëve të përcaktuara nga Komuna e Graçanicës.

Numri i ankesave

13

Ankesat e tërhequra

2

Ankesat nuk janë kredibile

0

Pjesërisht të miratuara

11

Ankesat e miratuara

0

FINANCIMI I SUBJEKTEVE POLITIKE

Raportet e auditura të pasqyrave financiare janë të publikuara vetëm për vitet 2009-2012. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nuk i ka publikuar asnjëherë pasqyrat financiare të SP për vitet para vitit 2009, pasi ato janë audituar nga OSBE.

Ndërsa pasqyrat financiare të SP politike pas vitit 2013 nuk janë të audituara sepse Kuvendi i Kosovës ka dështuar të përzgjedhë kompanië për auditim.

Kuvendi Komunal i Graçanicës përbëhet kryesisht nga anëtarë të SLS-së.

SLS gjatë periudhës 2009-2015 ka deklaruar vetëm një donacion të jashtëm në vlerë 3,000 euro. Ky donacion është pranuar brenda ditës dhe është në kundërshtim me kërkesat nga neni 5 i Rregullores 2004/2 mbi ("Shpërlarjen e parave"); përkatësisht- Ligji Nr. 03/L-196 për Parandalimin e shpërlarjes së parave dhe financimin e terrorizmit.

Lidhjet e biznesit me politikën


Nga të dhënat e nxerrura nga KRPP dhe të dhënat e pasqyrave financiare të SP, kemi arritur të identifikojmë pesë kompani të cilat kanë financuar SP dhe që kanë marrë tenderë nga KK Graçanicë.

Katër nga këto kompani kanë financuar PDK-në, e cila për një kohë të gjatë ka qenë në koalicion me SLS në nivelin qendror. Një kompani ka financuar subjektin politik "FER" e cila tashmë është e shuar.

Këto kompani kanë fituar 12 tenderë nga KK Graçanicë në vlerë 1,731,029 euro.

Financuesit e SP që fituan tenderë nga KK Graçanicë

Vlera e tenderëve të fituar



PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Në Komunën e Graçanicës del të ketë probleme të shumta në planifikimet, operimet dhe raportimet buxhetore. Raporti i Auditorit, i cili edhe është analizuar në përpikëri, ka nxjerrë në pah probleme të shumta të cilat ndikojnë në operimin funksional buxhetor, sidomos me planifikimin buxhetor dhe me realizimet buxhetore të parapara.

Dështimi në zbatimin e procedurave adekuate të prokurimit dhe kërkesave, si dhe menaxhimi i dobët i kontratave e cila mund të shkaktojë humbje financiare dhe pagesa të parregullta.

Në procesin e rishikimit të disa prokurimeve të Mallrave dhe shërbimeve Auditori gjeti disa mangësi në procedurën e prokurimit, siç janë:

- Mungesa e dokumentacionit adekuat gjatë pranimit të Mallrave;
- Nuk ka pasur shënime të dërgesës të bashkëngjitura në fatura;

Mungesat e lartpërmendura janë rezultat i kontrolleve të pamjaftueshme në fushën e prokurimit. Kontrollat e dobëta vërehen sidomos në planifikimin vjetor të prokurimit dhe regjistrimin e aktiviteteve të prokurimit. Në mungesë të një plani vjetor të prokurimit, Komuna ka ndërmarrë veprime ad-hoc për të realizuar procedurat. Rezultati i kësaj është joefikasiteti i caktuar në përdorimin e fondeve publike.

Mosrespektimi i procedurave të rregullta dhe vonesat në kryerjen e pagesave shtojnë rrezikun e shpenzimit joefikas të parave të buxhetit të prokurimit publik. E gjithë kjo tregon se komuna e Graçanicës ende përballet me vështirësi.

Auditorit Gjeneral kishte gjetur 4 raste në Komunën e Graçanicës ku ishte nënshkruar kontrata pa siguruar mjete të nevojshme. Në lidhje me këtë Kryetari të

Komunës i është rekomanduar të sigurojë mjete të mjaftueshme para realizimit të prokurimit.

Kryetari i Komunës duhet të shikojë pse kërkesat e prokurimit nuk janë zbatuar për rastet e lartpërmendura dhe të sigurojë që mangësitë të mos përsëriten. Kryetari duhet ta përmirësojë planifikimin buxhetor dhe të gjitha shërbimet duhet të parashihen në kuadër të kategorisë së Mallrave dhe Shërbimeve.

Të gjitha këto kanë të bëjnë me planifikimin buxhetor me theks të veçantë në planifikimin e Mallrave dhe Shërbimeve me qëllim të shfrytëzimit efikas të mjeteve. Gjithashtu janë vërejtur dështimet në monitorimin e procedurave të prokurimit, si dhe në përmbushjen e kërkesave financiare që mund të rezultojë në pagesa potencialisht fiktive.

Marr parasysh rekomandimet ndër vite, konsiderojmë se është i nevojshëm adresimi i rekomandimeve të bëra nga auditori i jashtëm përmes një procesi sistematik. E gjithë kjo, do ndihmonte në adresimin e problemeve të shumta ndër vite e cila gjithashtu, do të ndikonte në evitimin dhe mos-përsëritjen e problemeve të tilla në vitet pasuese.

